

RAPORTI I TRANSPARENCËS

NET-SFS KRESTON

2018



Përmbajtje

Hyrje

1. Përshkrimi i strukturës ligjore, organizative dhe pronësia e auditorit të regjistruar
2. Në rastet kur auditori i regjistruar i përket një rrjeti, një përshkrim i rrjetit si dhe të masave ligjore e strukturore në rrjet
3. Përshkrimi i strukturës drejtuese të Shoqërisë
4. Përshkrimi i sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë së Shoqërisë dhe një deklaratë nga administratorët ose drejtuesit mbi efektivitetin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë
5. Të dhëna nga data kur u bë rishikimi i fundit i pavarur i cilësisë dhe sigurisë
6. Lista e entiteteve me interes publik të audituara nga auditori i regjistruar gjatë vitit të kaluar është paraqitur në Shtojcën 1
7. Deklaratë në lidhje me procedurat e pavarësisë të Shoqërisë e cila gjithashtu konfirmon se një rishikim i brendshëm i pajtueshmërisë me pavarësinë është kryer gjatë vitit të kaluar financiar
8. Deklarata mbi politikën e ndjekur nga Shoqëria lidhur me edukimin e vazhdueshëm të auditorëve ligjorë të regjistruar që kryejnë auditime në emër dhe për llogari të firmës së auditimit
9. Shuma totale e të ardhurave e auditorit të regjistruar, ndarë përkatësisht sipas shërbimeve të ofruara, në auditimet financiare të pavarura, këshillimet e taksave dhe shërbime të tjera të papërmendura më lart

Shtojca 1 -Entitete të Interesit Publik

Hyrje

Shoqëria Net-SFS Kreston sh.p.k (“Net-SFS Kreston”) me NUIS L42007012I, themeluar në datë 07.04.2014 është një shoqëri që ofron shërbime profesionale në Auditim, shërbime fiskale dhe shërbime konsulence. Net-SFS Kreston është një shoqëri e specializuar në auditim dhe është e regjistruar në Regjistrin Publik të IEKA-s, në Seksionin e Shoqërive të Ekspertëve Kontabël të Regjistruar, me vendimin Nr. 430 datë 17.10.2014 të Autoritetit të Regjistrimit. Si një firmë auditimi që kryen auditimin ligjor të llogarive vjetore të entiteteve me interes publik, Net-SFS Kreston sh.p.k (“Shoqëria”) po publikon raportin vjetor të transparencës në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 10091, datë 5 mars 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” lidhur me auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore dhe të pasqyrave financiare të konsoliduara vjetore.

Gjithë informacioni i dhënë në këtë raport lidhet me situatën e Shoqërisë Net-SFS Kreston sh.p.k më 31 dhjetor 2018.

1. Përshkrimi i strukturës ligjore, organizative dhe pronësia e auditorit të regjistruar

Shoqëria funksionon si një firmë me përgjegjësi të kufizuara. Mbajtësi i kuotave të Net-SFS Kreston sh.p.k është:

- Rezar Llukaçej 100%

2. Në rastet kur auditori i regjistruar i përket një rrjeti, një përshkrim i rrjetit si dhe të masave ligjore e strukturore në rrjet

Rreth Kreston International

Net-SFS Kreston i referohet një ose më shumë firmave anëtare të Kreston International, e cila është një kompani private britanike e kufizuar nga garancitë. Secila nga këto firma përfaqëson një entitet ligjor të ndarë dhe të pavarur. Përshkrimin e detajuar të strukturës ligjore të organizatës Kreston International dhe firmave të saj anëtare e gjeni në adresën www.kreston.com.

Kreston International ofron shërbime në fushat e auditimit, taksës, konsulencës dhe këshillimit financiar, në të gjitha industritë, shoqërive si private ashtu dhe atyre publike. Me një rrjet global firmash anëtare, në më shumë se 125 shtete. Kreston International sjell aftësi me nivel botëror dhe shërbime me cilësi të lartë për klientët e saj, duke i dhënë bizneseve njohuritë që i nevojiten për të adresuar sfidat më komplekse që ato hasin. Pothuajse 25,000 profesionistët e Kreston International janë të angazhuar për t’u bërë standardi i përsosmërisë.

Net-SFS Kreston në Shqipëri

Në Shqipëri, shërbimet e auditimit ofrohen nga Net-SFS Kreston sh.p.k. Shoqëria Net-SFS Kreston që funksionon në Shqipëri është pjesë e rrjetit ndërkombëtar Kreston International që nga viti 2014. Shërbimet e auditimit ofrohen nga zyra e vetme që ndodhet në Tiranë.

3. Përshkrimi i strukturës drejtuese të Shoqërisë

Shoqëria drejtohet nga drejtorët menaxhues.

Anëtarët e organeve të drejtimit të kompanisë:

- Rezar Llukaçej - CEO

Rezar Llukaçej vepron si administrator i Shoqërisë sipas statutit të Shoqërisë në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14 prill 2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Numri mesatar i punonjësve profesionistë të Net-SFS Kreston në 2018 ka qenë 7.

4. Përshkrimi i sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë së Shoqërisë dhe një deklaratë nga administratorët ose drejtuesit mbi efektivitetin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë

Shoqëria mban politika dhe procedura për të promovuar një kulturë të brendshme të bazuar në njohjen që cilësia është thelbësore në planifikimin dhe kryerjen e angazhimit dhe të përcaktuara në Manualin e Politikave të Net-SFS Kreston. Ky sistem përfshin politika dhe procedura që adresojnë përgjegjësitë e udhëheqjes për sistemin e kontrollit të cilësisë brenda Shoqërisë, kërkesat etike, pranimin e klientit, angazhimit dhe vazhdimësisë, burimet njerëzore, performancën e angazhimit dhe monitorimin.

Ky sistem i kontrollit të brendshëm të cilësisë ka dy sisteme monitorimi:

- Rishikim i angazhimit të cilësisë dhe sigurisë dhe
- Rishikim i praktikës së firmës anëtare.

Rishikim i angazhimit të cilësisë dhe sigurisë

Raportet e auditimit ligjor mbi llogaritë vjetore ose llogaritë e konsoliduara në lidhje me një entitet me interes publik, ndër të tjera, para lëshimit i nënshtrohen një rishikimi të angazhimit të cilësisë dhe sigurisë nga eksperti kontabël i Shoqërisë me përvojë të mjaftueshme dhe të përshtatshme profesionale sipas angazhimit përkatës dhe industrisë.

Rishikimi i angazhimit të cilësisë dhe sigurisë përfshin një rishikim të raportit dhe pasqyrave financiare ose informacioneve të tjera financiare pjesë e raportit, memorandumit të planifikimit të auditimit, ose ekuivalenti, memorandumit të përmbledhjes së auditimit ose ekuivalenti, dokumenta të përzgjedhura të punës dhe dokumentacione të tjera që konsiderohen të përshtatshme si letra e angazhimit.

Ky rishikim gjithashtu përfshin një diskutim me partnerin e angazhimit të auditimit në lidhje me çështje të rëndësishme që dalin gjatë angazhimit ose rishikimit. Nëse rreziku i angazhimit është vlerësuar si më i madh se normal, ose shumë më i madh se normal, është i nevojshëm një rishikim më i gjerë, përfshirë një rishikim të dokumentacionit të përshtatshëm të punës që fokusohet në rreziqet e identifikuar dhe gjetjet përkatëse.

Raporti i auditimit mund të lëshohet vetëm nëse rishikuesi është i bindur që ekipi i angazhimit ka bërë gjykimet dhe ka arritur në përfundimet e duhura, dhe angazhimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe rregulloret të tjera sipas rastit.

Rishikim i praktikës së firmës anëtare

Rishikimi i praktikës së firmës anëtare përfshin praktikën e auditimit dhe është projektuar për të vlerësuar performancën e partnerit të auditimit të paktën një herë gjatë një periudhe tre vjeçare. Gjatë kësaj periudhe tre vjeçare, të paktën një angazhim përzgjidhet për rishikim. Vëmendje i kushtohet edhe vlerësimit të performancës së manaxherëve, veçanërisht atyre që janë kandidatë për partner në një periudhë afatshkurtër. Siç është përshkruar më lart, Shoqëria është pjesë e rrjetit Kreston International e cila çdo vit administron programet e veta të rishikimit të praktikës dhe harton programe të tilla për të mbuluar një sërë zyrash. Shoqëria është subjekt i një rishikimi praktike të paktën një herë në çdo tre vjet.

Shoqëria është përgjegjëse për rishikimin e praktikës, Kreston International ofron udhëzime dhe mbikëqyrje në lidhje me planet dhe procedurat e rishikimit. Koordinimi dhe administrimi i përgjithshëm i programit të rishikimit është përgjegjësia e drejtorit të rishikimit të kompanisë, në bashkëpunim me drejtorin rajonal të rishikimit, kur është e zbatueshme.

Objektivat e rishikimit të praktikës:

- Të marrë siguri të arsyeshme lidhur me pajtueshmërinë me politikat dhe proçedurat e Kreston International, përsa i përket auditimit;
- Të vlerësojë efektivitetin operativ të manaxhimit të rrezikut dhe proçedurat e kontrollit të cilësisë;
- Të vlerësojë zbatimin e standardeve profesionale dhe kërkesat rregullatore dhe ligjore;
- Të marrë siguri të arsyeshme se metodologjia e auditimit Net-SFS Kreston është zbatuar sic duhet; dhe
- Të marrë siguri të arsyeshme se sistemi i kontrollit të cilësisë të Net-SFS Kreston është projektuar në mënyrën e duhur, relevante, të përshtatshme, që vepron në mënyrë efektive dhe në përputhje me praktikën.

Gjetjet dhe rekomandimet që rezultojnë nga rishikimet e praktikës paraqiten në një raport rishikimi të praktikës dhe letër të manaxhimit që i adresohet drejtimit të Shoqërisë. Qëllimi i letrës së manaxhimit është të ofrojë sygjerrime për përmirësim në përgjigje të gjetjeve të vërejtura. Shoqëria i trajton gjetjet në raportin e rishikimit të praktikës duke hartuar një plan të detajuar veprimi, duke përcaktuar veprimet që duhet të ndërmerren, personat përgjegjës dhe koha për zbatimin e rekomandimeve të paraqitura në letrën e rishikimit të praktikës, kur është e zbatueshme.

Përveç kësaj, i komunikohen partnerit dhe personelit përgjegjës, mangësitë (nëse ka) të vëna në dukje si rezultat i rishikimit të praktikës dhe rekomandimet për masat e duhura korrigjuese. Shoqëria gjithashtu mbi një bazë vjetore komunikon rezultatet e rishikimit të praktikës dhe konsideratën dhe vlerësimin e vazhdueshëm të sistemit të tyre të kontrollit të cilësisë ndaj partnerëve dhe individëve të tjerë brenda Shoqërisë.

Deklarata e komitetit drejtues

Komiteti drejtues i Shoqërisë beson se sistemi i kontrollit të brendshëm, siç është përshkruar më sipër, është efektiv në dhënien e sigurisë së arsyeshme që Shoqëria dhe personeli i saj veprojnë në përputhje me standardet profesionale të zbatueshme dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore, si dhe që raportet e auditimit të lëshuara janë të përshtatshme sipas rrethanave përkatëse.

5. Të dhëna nga data kur u bë rishikimi i fundit i pavarur i cilësisë dhe sigurisë

Rishikimi më i fundit lidhur me kontrollin e cilësisë të firmës nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ka qënë në lidhje me vitin 2014 dhe raporti i inspektorëve, datuar në 15 prill 2015 shprehet me vlerësimin “mirë” për nivel firme dhe nivel auditimi (dosje).

6. Lista e entiteteve me interes publik të audituara nga auditori i regjistruar gjatë vitit të kaluar është paraqitur në Shtojcën 1

7. Deklaratë në lidhje me procedurat e pavarësisë të Shoqërisë e cila gjithashtu konfirmon se një rishikim i brendshëm i pajtueshmërisë me pavarësinë është kryer gjatë vitit të kaluar financiar

Shoqëria vetë mban politika dhe procedura të shkruara të pavarësisë, të cilat përfshijnë kryerjen e kontrolleve të caktuara të pajtueshmërisë me pavarësinë në baza vjetore.

- Çdo profesionist duhet të nënshkruajë çdo vit një deklaratë individuale pavarësie. Përveç kësaj, konfirmime të ngjashme pavarësie merren nga të punësuarit e rinj dhe ata që lënë kompaninë;
- Të gjithë profesionistët duhet të konfirmojnë njohjen dhe zbatimin mbi rregullat e pavarësisë dhe;
- Proçeset e procedurat e pranimit të klientit dhe angazhimit përdoren për të verifikuar që pavarësia nuk çënohet.

8. Deklarata mbi politikën e ndjekur nga Shoqëria lidhur me edukimin e vazhdueshëm të auditorëve ligjorë të regjistruar që kryejnë auditime në emër dhe për llogari të firmës së auditimit

Të gjithë auditorët e kompanisë azhurnojnë dhe thellojnë njohuritë e tyre teknike dhe profesionale nëpërmjet kurseve të shumta që ofrohen nga vetë kompania si dhe nga kurse apo trajnime që organizohen jashtë kompanisë nga organe profesionale të akredituara.

Edukim i vazhdueshëm

Edukimi i vazhdueshëm është një politikë kyçe e Shoqërisë, pasi ky është një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e njohurive, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve tona. Kreston webinar ofron një pikënisje, përfshirë trajnim teknik (GAAP, GAAS, rregullat profesionale, taksa, IT), menaxhimin dhe aftësitë e të punuarit me të tjerë, kurse biznesi, ekonomiku dhe për industri specifike. I gjithë stafi kërkohet që të marrë pjesë në trajnimet mbi Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, legjislacionin fiskal dhe rregulloret tregtare të zbatueshme. Trajnimet vjetore të përditësimit të njohurive në fushën e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar janë të detyrueshme për të gjithë stafin profesional të auditimit.

Programi i edukimit të vazhdueshëm është i përbërë nga sesione trajnimi të organizuara nga Net-SFS Kreston si dhe trajnime të jashtme.

Nëpërmjet një sistemi të monitorimit që ndiqet nga Departamenti i Burimeve Njerezore, është e mundur të kontrollohet situata e kurseve të kryera brenda kompanisë dhe atyre të ofruara nga insitucione të akredituara jashtë kompanisë të ndjekura nga secili auditor. Kualifikimi i vazhdueshëm është gjithashtu një faktor që merret në konsideratë për vlerësimin vjetor të personelit të auditimit dhe vlerësimi i potencialit të tyre të rritjes në kuadër të Shoqërisë.

9. Shuma totale e të ardhurave e auditorit të regjistruar, ndarë përkatësisht sipas shërbimeve të ofruara, në auditimet financiare të pavarura, këshillimet e taksave dhe shërbime të tjera të papërmendura më lart

Shënime shpjeguese në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 10091, datë 5 mars 2009 i ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, datë 28 prill 2016 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar".

Ndarja e të ardhurave vjetore të Net-SFS Kreston për 2018:

Të ardhurat	LEK
Auditimi Ligjor	13,050,333
Shërbime të tjera	699,651
Totali	13,749,984

Shtojca 1 -Entitete të Interesit Publik

Shënime shpjeguese në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 10091, datë 5 mars 2009 i ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, datë 28 prill 2016 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar".

Entitetet e Interesit Publik të Audituara për Qëllime Ligjore nga Net-SFS Kreston në vitin financiar 2018:

Emri	Për vitin e mbyllur më
Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike (OSHEE) Sha	31 dhjetor 2018
Smart Insurance Sha	31 dhjetor 2018